



Prishtinë: 30.10.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1069\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_1882\_10\_18**;

në seancën e mbajtur më datë 30.10.2018, nxori këtë:

### V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit **E.T.** nga Komuna e Ferizajt si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. OBLIGOHOET KESCO** që konsumatorin me shifër DFE-9016436 ta liroj nga korrigjimi plotësues nr. 20137DFE-9016436 i datës 23.01.2013 në vlerë **21,296.07€**
- III. OBLIGOHOET KESCO** që konsumatorin me shifër DFE-9016436 ta ngarkoj me korrigjim plotësues prej **22%** për periudhën **01/2012** deri ne periudhën **12/2012**.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 17.11.2016 konsumatori E. T. me shifër DFE - 9016436 ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.20137DFE-9016436 të datës 23.01.2013, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 13.12.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.96257209, ku TL=3321.9 kWh dhe TU=177.1 kWh, si dhe R1=3420.9 kVar dhe R2=164.0 kVar. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar në procesverbal që njehsori elektrik dhe TMRR-të posedojnë vula distributive, por që në momentin e inspektimit nuk kanë pasur mundësi teknike të bëjnë matjen për shkak të trashësisë së përçuesve. Po ashtu ekipi i KEK-ut ka evidentuar si vërejtje që duhet të bëhet mufizimi i tensioneve nga ekipet e matjeve.

**Provë:** Procesverbali i inspektimit nr.1828573 i datës 13.12.2012

Me datë 15.01.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.96257209 prej TL=3391.54 kWh dhe TU=183.78 kWh. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut



kanë evidentuar në procesverbal që njehsori elektrik është i vulosur me vula distributive, TMRR-të posedojnë vula distributive me numër C 70009253, C 70009254 dhe C 70009255, përçuesit e tensionit nuk janë të mufuar, por që në momentin e inspektimit kanë konstatuar se njeri TMRR nuk funksionon dhe njehsori elektrik nuk e regjistron elektrike në këtë fazë, e që nënkupton se energjia e njëjës fazë nuk matet. Rryma në primarin e TMRR-së është  $I=503A$ .

**Provë:** Procesverbal i inspektimit nr.222692 e datës 15.01.2013

Me datë 29.01.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin dhe kontrollimin e grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar që është bërë ndërrimi i vendit të grupit matës, pasi që ka qenë në vend të pa përshtatshëm për lexim, si dhe është bërë mufimi i tensioneve si dhe vulosja e TMRR-ve dhe grupit matës.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin e grupit matës nr. 6/3 i datës 29.01.2013

Departamenti i faturimit në KEK me datë 21.03.2013 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimin plotësuese nr.20137DFE-9016436 në vlerë financiare **21,296.07€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 01/2012 deri në periudhën 12/2012 për shkak të mos matjes së shpenzimeve në njëjën fazë.

**Provë:** Korrigjimi nr. 20137DFE-9016436 i datës 23.01.2013

Me datë 12.02.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar korrigjimin plotësuese nr. 20137DFE-9016436 të datës 23.01.2013.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit datë 12.02.2013

Me datë 11.11.2016 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalet e inspektimit nr. 1828573 datë 13.12.2012, nr. 222692 datë 15.01.2013 si dhe raportit mbi kontrollimin e grupit matës nr. 6/3 datë 29.01.2013.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 11.11.2016

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues nr. 20137DFE-9016436 datë 23.01.2013.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në ZRRE-së datë 17.11.2016

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes procesverbalin e inspektimit nr.1828573 të datës 13.12.2012 në të cilën punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.96257209 prej  $TL=3321.9$  kWh dhe  $TU=177.1$  kWh si dhe  $R1=3420.9$  kVar dhe  $R2=164.0$  kVar. Bordi i ZRRE ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut në procesverbal kanë evidentuar që njehsori elektrik dhe TMRR-të posedojnë vula distributive, por që në momentin e inspektimit nuk kanë pasur mundësi teknike të bëjnë matjen për shkak të trashësisë së përçuesve. Po ashtu punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar si vërejtje që duhet të bëhet mufimi i tensioneve nga ekipet e matjeve.

**Provë:** Procesverbal i inspektimit nr.1828573 i datës 13.12.2012

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 15.01.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 96257209 ku  $TL=3391.54$  kWh dhe  $TU=183.78$  kWh. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut në procesverbal kanë evidentuar që njehsori elektrik është i vulosur me vula distributive, TMRR-të posedojnë vula distributive me numër C 70009253, C 70009254 dhe C 70009255, përçuesit e tensionit nuk janë të mufuar, por që në momentin e inspektimit kanë konstatuar se njeri TMRR nuk funksionon dhe njehsori elektrik nuk e regjistron elektrike në këtë fazë e që nënkupton se energjia e njëjës fazë nuk matet. Rryma në primarin e TMRR-së është  $I=503A$ .



**Provë:** Procesverballi i inspektimit nr.222692 i datës 15.01.2013

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin dhe kontrollimin e grupeve matëse me datë 29.01.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar që: është bërë ndërrimi i vendit të grupit matës pasi që ka qenë në vend të pa përshtatshëm për lexim, si dhe është bërë mufimi i tensioneve si dhe vulosja e TMRR-ve dhe grupit matës. Bordi i ZRRE-së ka analizuar tri procesverbalet e përpiluara nga ekipet e KEK-ut e në veçanti procesverballin nr.222692 të datës 15.01.2013, sipas së cilit në asnjë mënyre nuk vërtetohet se ekipet e KEK-ut kanë vepruar në çfarëdo forme për marrjen e masave të parapara me kodet teknike të matjes për rregullimin e matjes së energjisë së shfrytëzuar nga konsumatori, përveç që kanë evidentuar se njëra fazë nuk bënë matjen në atë fazë.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin e grupit matës nr.6/3 i datës 29.01.2013

KESCO ka ofruar po ashtu raportin me analizat e nxjerra nga AMR dhe të dhënat nga CRMS ku ka konstatuar se njehsori elektrik nr.96257209 ka pasur mungesë të rrymës I2 për periodën 07/2011 deri ne 01/2013 përkatësisht deri me 16.01.2013 gjegjësisht gati 19 muaj kurse dy sisteme njehsori i ka regjistruar saktë andaj edhe korrigjimi është bërë saktë sipas dallimit 1/2 e energjisë së matur. Në raport po ashtu është theksuar se korrigjimi është bërë sipas kodit të matjes për periudhën 12 mujore, ndërsa pjesa me e vjetër prej 7 muajve ka ngel në dobi të konsumatorit. Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori nga periudha 05/2008 ka ndërruar grupin tarifor nga 7/01 në 6/6, si dhe është vërejtur se konsumatori ka lexime të rregullta të shpenzimeve mujore. bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka rritje graduale të shpenzimit të energjisë elektrike: periudha 01/2009 deri në periudhën 12/2009 mesatarja mujore e shpenzimeve është 37,500 kWh/muaj, periudha 01/2010 deri në periudhën 12/2010 mesatarja mujore e shpenzimeve është 28,200 kWh/muaj, periudha 01/2011 deri ne periudhën 12/2011 mesatarja mujore e shpenzimeve është 38,100 kWh/muaj, periudha 01/2012 deri në periudhën 12/2012 mesatarja mujore e shpenzimeve është 29,700 kWh/muaj, periudha 01/2013 deri në periudhën 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimeve është 38,100 kWh/muaj, periudha 01/2014 deri në periudhën 12/2014 mesatarja mujore e shpenzimeve është 39,900 kWh/muaj, periudha 01/2015 deri në periudhën 12/2015 mesatarja mujore e shpenzimeve është 47,400 kWh/muaj, periudha 01/2016 deri ne periudhën 12/2016 mesatarja mujore e shpenzimeve është 45,000 kWh/muaj, si dhe periudha 01/2017 deri n, periudhën 12/2017 mesatarja mujore e shpenzimeve është 44,700 kWh/muaj. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike vërehet se konsumatori në periudhën 2010 dhe 2012 ka rënie të shpenzimit krahasuar me shpenzimet e me hershme 2009, si dhe me shpenzimet e me vonshme 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Bordi i ZRRE-së ka krahasuar shpenzimin një vit para, pra 2011 dhe një vit pas 2013 me shpenzimet e vitit 2012 dhe konstaton se ky ndryshim është: në rastin e parë 28% dhe rastin e dytë 28.7%.

**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrike aktive

Departamenti i faturimit në KEK me datë 23.01.2013 bazuar në procesverbalet e inspektimit nr.1828573 të datës 13.12.2012, nr.222692 të datës 15.01.2013 dhe Raporti mbi kontrollimin e grupit matës nr.6/3 të datës 29.01.2013 ka bërë korrigjimin plotësues nr.20137DFE-9016436 në vlerë 21,296.07€ për faturat e periudhës 01/2012 - 12/2012 duke ri faturuar faturat e asaj periudhe për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik nr.96257209 përkatësisht për 1/2 e energjisë së pa faturuar. Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KEK dhe konstaton se KEK ka gabuar pasi që vlera e kWh të faturuara si plotësim për periudhën 01/2012 - 12/2012 nuk korrespondon me shpenzimet reale të konsumatorit ndër vite. Po ashtu në raportin e analizave dhe përshkrimit të gjendjes faktike të ofruar nga KESCO është konstatuar se gjendja e regjistrimit të shpenzimeve të konsumatorit është e saktë pas datës 16.01.2013 duke mos dhënë asnjë provë mbi masat e ndërmarra me datë 16.01.2013 në evitimin e matjes jo të saktë të njehsorit elektrik me datë 16.01.2013. Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh të gjitha këto argumente konstaton



se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi i faturave për periudhën 01/2012 deri në periudhën 12/2012 duke e bërë faturimin plotësues për 22%, bazuar në nenin 4.11.2 të Kodit të Matjes, në të cilin theksohet se: *“Në rastin kur konstatohet se njehsori ka gabuar 100, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprake të shpenzimit të konsumatorit, gjithashtu te rastet e defektit të ndonjë sistemi matës (pa ndonjë ndërhyrje të qëllimshme) veprohet me mesatare duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar”.*

**Provë:** Korrigjimi plotësues nr. 20137DFE-9016436 i datës 23.01.2013

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: E. T.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.